

P.nr.1433/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i Përgjithshëm-Penal, gjyqtari, Kujtim Krasniqi, me zyrtaren ligjore Dafina Ymeri, në çështjen penale kundër të pandehurit H.I. nga F., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.74/17 të datës 20.03.2017, jashtë seancës, me datë 10.04.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë- departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.74/17 të datës 20.03.2017, për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor,

Andaj gjykata konformë nenit 495 të KPPK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR**I akuzuari;**

H.I., i ati F., i lindur mëdt:..., në fshatin K., me vendbanim në Rr. "I.M." në F., me nr. personal ..., shqiptar, -shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR**Sepse,**

Me datë 26.12.2016, rreth orës 21:45, në rrugën magjistrale Prishtinë –Mitrovicë, saktësisht në fshatin M. te hotel "Sh." i pandehuri H.I., deri sa ishte duke drejtuar automjetin e tipit "VW Pasat 3C" ngjyrë e kaltër, me targa ..., nga pakujdesia e në kundërshtim me nenin 126.1, të LSKRR, ka rrezikuar pjesmarrësit në komunikacion dhe ka vu në rrezik jetën e njerëzve, ashtu që duke mos mbajtur distancën e mjaftueshme të sigurisë në komunikacion, me pjesën e përparme ballore e godet në pjesën e pasme automjetin "VW Pasat", ngjyrë e kaltër, me targa nr. ..., të cilën e drejtonte R.O., i cili ishte duke lëvizur në të njëjtin shirit dhe drejtim, me ç'rast ka pasur dëme në automjete, dhe i dëmtuari R.O. dhe bashkëudhëtari i tij B.O. kanë pësuar lëndime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin.

-me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform neneve 4, 41, 43, 46, 73 të KPK, si dhe neneve 365 e 495, të KPPK-së i shqipton

DËNIMIN ME GJOBË

Nëshumë prej **200(dyqind) Euro**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prere të këtij aktgjykimi.

Dënimin e shqiptuar i pandehuri mund ta paguaj deri në 2 (dy) këste mujore në afat kohor prej 2 (dy) muaj, deri në datën 5 të muajit vijues nga dita e marrjes së formës së prere e këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës me këste do ta revokoj dhe konform nenit 46 të KPK-së i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi **duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.**

Obligohet: i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale gjykatës t'ia kompensoj shumën prej **40.88** euro për ekspertizën e komunikacionit, shumën prej **20** euro te ekspertizës mjeko-ligjore, si dhe në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia kompensojnë shumën prej **30** euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim.

Idëmtuari – R.O., me vendbanim në Rr. “H.P.” O., lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti i përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.74/17 të datës 20.03.2017, kundër H.I. nga F., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuari sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.

Prokurori i çështjes, Gjykatës i ka propozuar që kundër të akuzuarit të lëshoj Urdhrit Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërin e aktakuzës së prokurorisë në drejtim të vërtetimit të fakteve të cilat vërtetojnë faktin se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 të KPPK-së Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së dhe vendosi që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Mendimi i ekspertit mjeko-ligjor datës 20.02.2017, mendimi i ekspertit të komunikacionit e datës 03.03.2017, si dhe të shikohen skica dhe fotografit e vendit të ngjarjes, janë prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Andaj Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësorë, u mor konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
 Departamenti i përgjithshëm-Penal
 P.nr.1433/17, të dt. 15.02.2018

Zyrtare Ligjore
 Dafina Ymeri

Gjyqtari,
 Kujtim Krasniqi

KËSHILLA JURIDIKE;

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga marrja e të njëjtit, kësaj Gjykate, pas kalimit të afatit për kundërshtim urdhri ndëshkimor, merr formën e prerë.